



Komuna e Klinës

Zyra e Kryetarit

01Nr. 312-5710/2019

Klinë, dt.07.02.2019

Duke u bazuar ne dispozitat nenit 13 dhe 58 te Ligjit per Vetëqeverisje Lokale, nr.03/L-040 publikuar ne Gazetën Zyrtare 28/2010, dispozitat e Ligjit per Eficiency te Energjisë, nr.06/L-079, si dhe dispozitat e nenit 91 te Statutit te Komunës së Klinës, me qellim te përmbushjes se obligimeve ligjore, kryetari i Komunës së Klinës me datën 07.02.2019 lëshon këtë:

V E N D I M

1. **AUTORIZOHEN**, drejtoritë komunale të Komunës së Klinës, të cilat kanë në administrim të tyre ndërtesa publike komunale, që t'u japin qasje për vizita në të gjitha këto ndërtesa, ekspertëve të angazhuar nga kompania "Links4" me qëllim të realizimit të aktiviteteve për krijimin e Sistemit për menaxhim komunal të energjisë në Komunën e Klinës, projekt i cili financohet dhe mbështetet nga Zyra e GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) në Kosovë.
2. Qëllimi i vizitës së ekspertëve në objektet publike komunale është:
 - 1.1. Intervistimi i personave përgjegjës (drejtorëve/menaxherëve) të ndërtesave komunale në lidhje me konsumin e energjisë (elektrike dhe termike);
 - 1.2. Matja e dimensioneve të mbështjellësit të objekteve (mureve të jashtme, dritareve të jashtme, dyerve të jashtme, kulmit, dyshemesë) të ndërtesave komunale dhe sipërfaqeve të brendshme që ngrohen;
 - 1.3. Marrja e të dhënave të ndërtesave komunale (viti i ndërtimit të ndërtesave, viti i renovimeve nëse është bërë renovimi, numri ngastrës kadastrale ku është vendosur objekti, faturat e energjisë elektrike dhe informata për shpenzimin e lëndës djegëse për ngrohje për tre vitet e fundit, informata për ndriçimin e brendshëm dhe të jashtëm të ndërtesës);
 - 1.4. Marrja e informatave për sistemet e ngrohjes qendrore, sistemet e ventilimit dhe klimatizimit (nëse ka), ujë të ngrohtë sanitar;
 - 1.5. Qasje në informata për ndriçimin publik të Komunës së Klinës si dhe informata tjera të nevojshme për projektin në fjalë.
3. Afati për qasje në objekte publike komunale për ekspertët në fjalë është nga data 21.01.2019 deri në përfundim të projektit, datë 30.10.2019.

Te njoftohen:

- Drejtoret e drejtorive;
- GIZ-i;
- Arkivi.

Kryetari
Zenun Dervishaj

